

FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

*Në mbledhjen e Qeverisë së Rebpulikës së
Maqedonisë të mbajtur më datë 27.03.2015
është dhënë pëlqim për ndryshimin e Statutit*

TEKST I SPASTRUAR

STATUTI
i Fondit të Sigurimit të Depozitave

Shkup, mars 2015

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Fondin e Sigurimit të Depozitave („Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 63/2000) Këshilli drejtues i Fondit për Sigurimin e Depozitave në mbledhjen e X-të të mbajtur më datën 24.05.2001, solli

STATUTI

i Fondit të Sigurimit të Depozitave

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHËME

Neni 1

Me këtë statut rregullohet:

- themelimi i Fondit;
- emri, vendndodhja, vula dhe shenja mbrojtëse e Fondit të Sigurimit të Depozitave (në tekstit në vijim: Fondi);
- objekt i punës së Fondit;
- mjetet e Fondit;
- plasmane të Fondit;
- informimi i Fondit;
- premitë e sigurimit të depozitave;
- mënyra e administrimit dhe organizimit të Fondit;
- shërndarja e fitimit, bartja e rrezikut dhe humbja;
- fshehtësi afariste;
- ndërprerja e anëtarimit në Fond;
- pyetje tjera të rëndësishme të punës së Fondit.

II. THEMELIMI I FONDIT

Neni 2

Fondi është themelua me Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave.

Themelues i Fondit është Republika e Maqedonisë.

Fondi është pasardhës ligjor i Fondit të Sigurimit të Kursimeve Depozitare sh.a. Shkup. Kapitali themeues i Fondit paraqet shumën prej 10.299.958,00 denar.

Neni 3

Fondi ka cilësi të personit juridik dhe në transaksionet juridike me persona të tretë vepron me emër të vetë dhe për llogari të vetë.

Për obligimet në transaksionet juridike Fondi përgjigjet me tërë pronën e tij.

Neni 4

Në cilësi të pasardhësit juridik Fondi i merr të gjitha obligimet dhe kërkesat prej Fondit të Sigurimit të Kursimeve Depozitare sh.a. Shkup.

Mjetet, e mbëledhura në Fondin e Sigurimit të Kursimeve Depozitare sh.a. Shkup në bazë të premisë teknike dhe neto – fitimeve të Fondit prej themelimit të tij deri në orjentimit të mjeteve të këtij Fondi, të njejtat barten dhe mund të përdoren vetëm për dmshtëpërblimin e depozitarëve në rast të ndodhjes së ndonjë situatë të rrezikut në ndonjë bankë ose kursimore.

III. EMRI, VENDNODHJA, VULA DHE SHENJA MBROJTËSE (Logo)

Neni 5

Emri i Fondit është: Fondi për Sigurimin e Depozitave.

Në korespondencë me jashtë Fondi e përdor emrin në gjuhën angleze: Deposit Insurance Fund-

Neni 6

Vendndodhja e Fondit është në Shkup, në adresën: "11 Tetori" numër 18 Shkup.

Neni 7

Fondi ka vulë dhe shtenbil.

Fondi i përdor llojet e vulaave si vijojnë:

1. Dy vula në formë të rrumbullakët madhësia e të cilave është 32 mm.
 - a) Në vulë është i shënuar emri i Fondit me alfabet kirilik: "Fondi për Sigurimin e Depozitave" dhe
 - b) Në vulë është i shënuar emri i Fondit në gjuhën angleze: "Deposit Insurance Fund"
2. Vulë në formë drejtëkëndore e cila është në madhësi prej 45 mm. Në vulë është i shënuar emri i Fondit, vendi për numrin dhe datën e Regjistrimit të Fondit.
3. Vulë tekstuale.
4. Shtenbil për prenim të postës, me numër të arkivit.

Neni 8

Shenja mbrojtëse, amblema dhe lloji i logos të shkronjave të Fondit dukete kështu:

FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Amblemë e veçantë e përpunuar dhe stilizuar nuk do të përdoret.

Ngjyra mbrojtëse e Fondit është e zezë.

Madhësia e shkronjave është proporcionale në dimensionet e objektit për të cilin shkruhet.

neni 9

Mënyra e përdorimit të vulës, shtembilit dhe shenjës mbrojtëse do të përcaktohen me rregullore e cila do të sillet nga ana e Këshillit drejtues të Fondit.

Neni 10

Gjatë kohës së qarkullimit të planifikuar në vend Fondi mundet të hapi llogari në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe llogari në ndonjë bankat të cilat kanë marr pëlqim për realizimin e qarkullimit pagesor në vend.

IV. LËNDA E PUNËS SË FONDIT

Neni 11

Lënda e punës së Fondit është Sigurimi i depozitave të personave fizik nëpër banka, filiale (degë) të bankave të huaja, dhe kursimore në Republikën e Maqedonisë.

Lëndë sigurimi në Fond janë depozitat e personave fizik në vijim:

- depozita në denar dhe deviza dhe llogaritë transakcionale të personave fizik nëpër banka, degë të bankave të huaja dhe kursimore në Republikën e Maqedonisë,
- çertifikata për depozita,
- depozita të lidhura me kartela parash të lëshuara nga banka, degë të bankave të huaja të themeluara në Republikën e Maqedonisë, dhe
- të hyra devizore të personave fizik në banka në Republikën e Maqedonisë.

Në rast të dëmshpërblimit nga ana e Fondit, depozitat e një personi të ndara veç e veç në ndonjë bankë, degë të bankës së huaj ose kursimore llogariten si një depozitë i vetëm.

Neni 11 a

Fondi i siguron depozitat e përgjithshme të deponuara tek anëtarët e veta deri në ditën e vendimit përfundimtar të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë:

- për nadasë të mbledhjes së depozitave të anëtares e cila është përjashtuar nga anëtarësimi në Fond për arsye të mos pagesës së premisë, dhe
- ndërprerje të lejes për themelim të punës, anëtares së Fondit”.

Neni 12

Fondi nuk i dëmshpërblen depozitat e personave fizik si vijojnë:

1. depozita të cilave i'u është dhënë kushte të normave të interesit të privileguara, të ndryshme nga ata të publikuara nga banka, dega e bankës së huaj ose kursimorja;
2. depozita të pronarëve të mbi 5% të akcioneve me të drejtë menaxhimi me bankën ose kursimoren;
3. depozita të anëtarëve të organeve të menaxhimit me bankën, degën e bankës së huaj ose kursimoren;
4. depozita të familjarëve të rendit të parë të personave nga pika 2 dhe 3 e këti neni.
5. Depozita të cilat janë të lidhura me transakcione me anë të së cilave është bërë larje parash ose financim i terorizmit, në rast se shkelsi është dënuar me dënim i cili është akoma në fuqi.

Në rast se depozitori ka obligime ndaj bankës, filiales së bankës së huaj ose kursimores shuma e përgjithshme e depozitave të depozitorit zvogëlohet për shumën e obliguar, të cilat depozitori i ka ndaj bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores.

Në rast të depozitit të përbashkët llogaritet se pjesët e investuesëve janë të jjejtta në rast se nuk është përcaktuar ndryshe në marrveshje.

Neni 13

Fondi i dëmshpërblen depozitat e siguruara, por jo më tepër se 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në një bankë, degë të bankës së huaj ose kursimore të përlllogaritura sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e aktvendimit përfundimtar për ndërprerje të lejes së themelimit të punës së bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores.

Në shumën nga pika 3 e këti neni përlllogaritet principali i depozitës, norma e interesit për të cilën janë marr vesht, ajo e përlllogaritur dhe interesi i paarritur deri në ditën e aktvendimit përfundimtar për ndërprerje të lejes për themelim të punës së bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores.

Në ditën e aktvendimit përfundimtar për ndërprerje të lejes së themelimit të punës së bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores depozita e investuara në valutë të huaj do të konvertohen në denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Dëmshpërblimi i depozitave në denar dhe deviza do të paguhet në denarë.

Neni 14

Fondi nuk përgjigjet për normën e interesit të shumave të garantuara të bazuara në shumat e dëmshpërblimit nga dita e aktvendimit përfundimtar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë nga neni 11a, deri në ditën e pagimit të dëmshpërblimit.

Për kërkesat mbi mjetet e paguara(marra) nga Fondi në pajtim me paragrafin 1 të nenit 13 të këti Statuti, personat fizik të cilët i fitojnë të drejtat e tyre nga prona e bankës, degës së bankës së huaj gjegjësisht kursimores në pajtim me ligjin.

Neni 15

Banka, dega e bankës së huaj dhe kursimorja, anëtare e Fondit, janë të obliguara që në sportelet në të cilat realizohet pagesë të vendosin njoftimin për depozitat të cilat janë të siguruara në Fond si dhe për shumën e dëmshpërblimit nga ana e Fondit.

Tekstin e njoftimit nga ky nen e përcakton Këshilli drejtues i Fondit.

Neni 16

Fondi fillon me dëmshpërblimin e depozitave të siguruara në afat prej 20 ditësh nga dita e sjelljes së aktvendimit përfundimtar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për ndërprerje të punës themelimit të punës së bankës, filijales së bankës së huaj ose kursimores.

Në rrethana të jashtëzakonshme, Fondi mund ta vazhdoj afatin nga paragrafi 1 i këti neni për më së shumti dhjetë ditë.

Neni 17

Shuma e mjeteve të paguara në bazë të nenit 13 të këti Statuti, Fondi i paguan nga të hyrat e mjeteve nga likuiditeti gjegjësisht masa e pasurisë së anëtares tek e cila është vendosur procedurë likuiditeti gjegjësisht falimentim në pajtim me ligjin.

Neni 18

Fondi përgatit Rregullore me anë të së cilës rregullohen aktivitetet e Fondit për Sigurimin e Depozitave në lidhje me sigurimin e depozitave të personave fizik, si dhe përdorimit të mjeteve të Fondit, në rast të dëmshpërblimit të depozitave të siguruara.

Rregulloren nga paragrafi 1 i këti neni e sjell Këshilli drejtues i Fondit.

V. MJETET E FONDIT

Neni 19

Mjetet e Fondit formohen nga investimi themelor, pagesa e premive për sigurimin e depozitave të personave fizik, pagesë për premi hyrse dhe të ardhura nga plasmanet.

Mjetet nga pagesa e premive për sigurim, premive hyrse dhe pagesa shtesë paraqesin të ardhura në rezervat për siguri të Fondit.

Neni 20

Mjetet monetare të Fondit paraqesin më së paku 4% nga depozitat e përgjithshme të personave fizik në banka dhe kursimore në Republikën e Maqedonisë.

Me mjete monetare të Fondit nënkuptohen mjetet të cilat gjenden në llogaritë e Fondit në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, llogaritë e Fondit në bankat afariste dhe mjete monetare të investuara në letra me vlerë.

Fondi është i obliguar që ta ruaj nivelin e mjeteve nga paragrafi 1 i këti neni.

Neni 21

Nëse Fondit i mungojn mjete për dëmshpërblimin e depozitave të siguruara të personave fizik, Fondi siguron mjete shtesë nëpërmjet:

1) pagesave shtesë nga ana e bankave, degëve të bankave të huaja dhe kursimoreve, por jo më tepër se sesa vlera e trefshit të premive të paguara në muajin me të cilin përkojnë me muajin në të cilin guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ka sjell vendim përfundimtar në pajtim me nenin 11a paragrafi 1 alinea 2 e këti Statuti

2) marrje hua në vend dhe jashtë vendit

3) hua nga Buxheti i Republikës së Maqedinisë.

Pagesa shtesë nga paragrafi 1 pika 1 e këti neni ju këthehen bankave, filialeve të bankave të huaja dhe kursimoreve pas shfrytëzimit të mjeteve të shfrytëzuara në interes të Fondit nga pasuria e bankës gjegjësisht likuiditeti i bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores tek e cila është vendosur procedura e likuiditetit gjegjësisht falimentimi, dhe në rast se ata nuk janë të mjaftueshme që të këthehet shuma e plotë e mjeteve të paguara shtesë, mejet ju këthehen bankave, degëve të bankave të huaja dhe kursimoreve në mënyrë të barabartë si mjete të paguara shtesë.

Pagesat shtesë nga paragrafi 1 pika 1 e këti neni bankat, degët e bankave të huaja dhe kursimoret janë të obliguara që mjetet t'i paguajnë në llogari të Fondit, më së voni në afat prej 8 ditësh nga dita e sjelljes së përllogaritjes nga ana e Fondit deri tek bankat, degët e bankave të huaja dhe kursimoret.

VI. PLASMANET E FONDIT

Neni 22

Mjetet me të cilat disponon Fondi mund të plasohen në:

1) letra me vlerë të lëshuara nga ane e Republikës së Maqedonisë dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë me afat maturimi prej 12 muaj nga marrja në pronësi nga ana e Fondit dhe

2) letra obligative me vlerë të lëshuara nga shtete të huaj, banka qendrore ose institucione ndërkombtare financiare publike, të ranguara nga ana e më së paku dy agjensive të pranuar ndërkombtare për vlersueshmërinë e rrezikut kreditor nga njëri nga dy kategoritë më të larta, në shumën e depozitave të siguruara të cilat janë në valutë të huaj.

Mjetet e Fondit mund të shfrytëzohen vetëm për dëmshpërblim të depozitave të siguruara të personave fizik dhe për mbulimin e harxhimeve për punën e Fondit.

VII. PREMITE PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Neni 23

Për sigurimin e depozitave Fondit i paguhet premi nga anëtarët e Fondit me normë interesi më së shumti deri në 0,7% në vit nga vlera e përgjithshme e depozitave në çdo bankë, filjalë e bankës së huaj dhe shtëpisë së kursimit.

Mënyrën, afatin e pagimit dhe shumën e premisë nga paragrafi 1 i këtij neni e cakton Këshilli drejtues i Fondit.

Në rast të vonësës së pagimit të premisë nga paragrafi 1 i këtij neni, Fondi përllëgërit dhe vendos pagesë me kamatvonesë ligjore.

Mjetet e paguara në bazë të premive në Fond nga ana e bankave, filjaleve të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimeve janë të pakëthyeshme.

Themelimi i bankave të reja, filialeve të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit gjatë antarsimit në Fond, duhet të paguajnë premi në vlerë prej 1% nga kapitali bazë, ndërsa mënyrën dhe afatin e pagesës hyrse e përcakton Këshilli drejtues i Fondit.

Neni 24

Baza për përllëgëritjen e shumës së mremisë për sigurimin paraqet gjendjen e bilancit të depozitave të përgjithshme tek anëtarët prej muajit të kaluar, në bazë të raporteve mujore për depozitat e përgjithshme në banka, degë të bankave të huaja dhe kursimore të cilët Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë i dorëzon në Fond.

Neni 25

Premia për sigurim paguhet në mënyrë mujore, gjegjësisht 1/12 nga shuma e përllëgëritur për premi duke aplikuar bazën e nenit 24 dhe normën e premisë nga neni 23 paragrafi 2.

Neni 26

Këshilli drejtues mund të sjell vendim për ndërprerje të detyrimit për pagim të premisë në Fond nga ana e bankave, degëve të bankave të huaja dhe kursimoreve- anëtare në Fond, në rast se mejetet financiare të Fondit do ta kalojnë 4% e nivelit ligjor nga depozitate e përgjithshme të personave fizik në banka, degë të bankave të huaja dhe kursimore.

Me përjashtim të vendimit nga paragrafi 1 i këti neni, bankat, degët e bankave të huaja dhe kursimoret paguajnë premi në periudhën kur janë nën masat shtesë nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 133 të Ligjit për banka ose që është vendosur administrim në pajtim me nenin 139 të Ligjit për banka dhe atë për normë premie të njetë për të gjithë, e përcaktuar nga ana e Këshillit drejtues të Fondit.

Neni 27

Në rast se banka, filialja e bankës së huaj ose kursimorja nuk paguajnë premi në periudhë prej gjashtë muajsh njëra pas tjetrës Fondi e informon Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

VIII. MBLEDHJA E INFORMATAVE NGA ANA E FONDIT DHE SHFRYTËZIMI I TYRE

Neni 28

Në lidhje me të gjitha informacionet relevante për gjendjen e anëtareve të Fondit, Fondi përdorë:

-raporte mujore për depozitat e përgjithshme nëpër banka, filijale të bankave të huaja dhe kursimore të cilat përmbajnë të dhëna për principalin dhe për normat e interesit të depozitave të cilat janë lëndë për sigurim në Fond, të dorëzuara në Fond nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, më së voni deri në ditën e 25 -të të muajit vijues, për muajin e kaluar.

-raporte financiare periodike në lidhje me të gjitha informacionet relevante për gjendjen e Fondit, të dorëzuara në Fond nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të Fondit,

- raporete për gjendjen financiare dhe perspektivat e bankës, degës së bankës së huaj dhe kursimores të dorëzuara me kërkesë të Fondit, ndërsa nga ana e e administratorit ose administratorëve të emëruar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, më së voni në afat prej 10 ditësh nga pranimi i kërkesës të dërguar nga ana e Fondit,

- raporte për bankat, degët e bankave të huaja dhe kursimoreve anëtare të Fondit të cilat janë nënmasa shtesë të ndërmarra nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 133 të Ligjit për banka ose që i është vendosur administrin në pajtim me nenin 139 të Ligjit për banka i dorëzuar me kërkesë të Fondit dhe nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, më së voni në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së dërguar nga ana e Fondit,

- raport të dorëzuar nga ana e bankave, degëve të bankave të huaja dhe kursimoreve për gjendjen tremujore të numrit të përgjithshëm të depozitorëve me depozita deri në 30.000 mijë euro dhe të depozitorëve me depozita mbi 30.000 mijë euro, dorëzimi duhet të bëhet më së voni deri në ditën e 15-të të muajit për tremujorin e kaluar.

Të dhënat e dërguara në Fond paraqesin informacione të klasifikuara.

Neni 29

Këshilli drejtues mund t'i shfrytëzoj informacionet e dorëzuara nga bankat në Fond, vetëm për realizimin e funksioneve të tij.

IX. MËNYRA E MENAXHIMIT DHE ORGANET E FONDIT

Neni 30

Organet e Fondit janë: Këshilli drejtues dhe drejtori.

IXa. Këshilli drejtues

Neni 31

Këshilli drejtues është i përbërë nga pesë anëtar të emruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe atë tre me propozim të ministrit të financave, një me propozim të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe një me propozim të Shoqërisë për Banka dhe Sigurim i cili duhet të jetë nga radhët e ekspertëve në lëminë e bankare dhe financiare i cili nuk duhet të jetë anëtar i organit drejtues ose i punësuar në bankë, degë të bankës së huaj ose kursimore.

Anëtarët e Këshillit drejtues emrohen me mandat prej katër viteve.

Nga radhët e anëtarëve, Këshilli drejtues e zgjedh kryetarin.

Për punën e vetë Këshilli drejtues përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë .

Neni 32

Anëtarët e Këshillit drejtues të Fondit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit për të cilin janë të emruar, nëse janë të dënuar për vepër penale kundër pronësisë ose për kundravajtje në punën e lëmisë financiare si dhe për mënyrën dhe procedurën e emrimit të tyre.

Neni 33

Këshilli drejtues i Fondit i kryen punët në vijim:

1. sjell statutin e Fondit, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e statutit të Fondit;
2. sjell akte nënligjore me anë të së cilëve rregullohet puna e Fondit;
3. shqyrton dhe miraton raportet gjysmë vjetore dhe vjetore të punës së Fondit;
4. shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar dhe llogarinë vjetore;
5. sjell vendim për përdorimin dhe shpërndarjen e fitimit të realizuar, gjegjësisht për mbulimin e humbjeve;
6. sjell vendim për mënyrën, afatin dhe shumën e pagesës së premisë;
7. sjell vendim për ndërprerje të detyrimit të pagesës së premisë në Fond nga ana e bankave ose kursimoreve.
8. sjell vendim për pagesa shtesë nga ana e bankave, degët e bankave të huaja dhe kursimoreve;
9. sjell vendim për huamarrje nga ana e Fondit në vend dhe jashtë vendit;
10. sjell vendime për shfrytëzimin e huamarrjeve të Fondit nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
11. sjell vendime për blerjen e letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë me afat maturimi deri në 12 muaj nga momenti i marrjes në pronësi nga ana e Fondit;
12. sjell vendime për blerjen e letrave obligative me vlerë të lëshuara (emëtuar) nga ana e shteteve të huaja, bankave qendrore ose institucioneve ndërkombëtare financiare

publike, të ranguara nga ana e më së paku dy agjensive të pranuar ndërkombëtare për vlersueshmërinë e rrezikut kreditor në nërën nga dy kategoritë më të larta, në shumën e sigurimit të depozitave të cilat janë në valutë të huaj;

13. vendos për kërkesat të anëtarimit të anëtareve të reja, të siguruar në Fond;

14. sjell vendim për ndërprerje të antarsimit të ndonjë banke, degë të bankës së huaj ose kursimore kur do të plotësohen kushtet e parapara me këtë statut;

15. sjell vendim për pagesën e depozitave të siguruar të personave fizik pas vendimit përfundimtar të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndërprerje të punës së bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores;

16. cakton revizor të autorizuar;

17. e miraton Rregulloren me anë të së cilës rregullohen aktivitetet e Fondit për Sigurimin e Depozitave në lidhje me sigurimin e depozitave të personave fizik, si dhe shfrytëzimin e mejteve të Fondit, në rast të dëmshpërblimit të depozitave të siguruar.

18. sjell vendim për furnizimin mjeteve bazë;

19. deri në sjelljen e vendimit nga ana e Komisionit për çështje banesore të Qeverisë së Maqedonis, Këshilli drejtues i Fondit mund të sjell vendim për mbulimin e shpenzimeve për çështjen e banimit të drejtorit të Fondit dhe shpenzimeve të tjera në lidhje me realizimin e funksionit, në rast se drejtori ka vendbanim jashtë vendndodhjes së Fondit,

20. formon trupa punues dhe komisione për relizimin e detyrave dhe i cakton kompetencat e tyre;

21. shqyrton precesverbale dhe raporte për relizimin e kontrollave dhe revizioneve të realizuara nga organ shtetëror kompetent si dhe nga shoqëri të autorizuar për kreyerje të revizionit;

22. sjell akt për organizim dhe sistematizim të brendshëm të Fondit;

23. jep iniciative dhe propozime për ndryshim dhe plotësim e dispozitave të cilat e rregullojnë lëminë e punës së Fondit;

24. propozon masa dhe aktivitete për përmirësimin e kushteve të përgjithshme për zhvillim të kursimit;

25. jep pëlqim për udhëtime zyrtare jashtë vendit, në rast se udhëtojnë më tepër se tre vetë të punësuar në Fond;

26. jep pëlqim për propozim – tekstin e Njoftimit për depozitat të cilat janë të siguruar në Fond dhe për shumën e dëmshpërblimit nga ana e Fondit, dhe

27. kryen punë të tjera të parapara me Statutin e Fondit dhe akteve të tjera të përgjithshme të Fondit.

Neni 34

Këshilli drejtues vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i Këshillit drejtues.

Seancat e Këshillit drejtues i fton dhe me udhëheq me ta Kryetari, ndërsa në mungesë të tij, person i autorizuar nga ana e tij.

Këshilli drejtues i Fondit mban mbledhje sipas nevojës.

Këshilli drejtues duhet të mbledhet në mënyrë të detyruar sipas kërkesës së shumicës së anëtarëve të Këshillit drejtues ose nga ana e drejtorit të Fondit.

Dispozitat më të afërta për thirrjen e seancave, mënyrën e punës dhe procedurën e vendosjes dhe të tjera rregullohen me Rregulloren e punës së Këshillit drejtues të Fondit .

IX6. Drejtori i Fondit

Neni 35

Drejtorin e Fondit e emron Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mandat prej katër viteve.

Për drejtor të Fondit për Sigurimin e Depozitave mund të emrohet personi i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave:

Neni 36

Drejtori i Fondit është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Fondit.

Në rast mungese të drejtorit, Fondin e përfaqëson person nga të punësuarit në Fond dhe atë për punë të caktuara për të cilat do ta autorizoj drejtori.

Neni 37

Drejtori i Fondit mund të shkarkohet përpara mbarimit të mandatit për të cilin është emruar:

- me kërkesë të tij dhe
- në rast se është i dënuar për vepër penale kundër pronës ose për shkelje nga lëmija e e punës financiare, për mënyrën dhe procedurën e emrimit të tij.

Neni 38

Drejtori i Fondit i ka kompetencat dhe autorizimet në vijim:

1. menaxhon punën e Fondit;
2. e përfaqëson Fondin;
3. i realizon vendimet e Këshillit drejtues të Fondit, gjegjësisht kujdeset për realizimin e tyre;
4. ngren iniciativa dhe jep propozime për avansimin e punës së Fondit;
5. vendos për blerjen e letrave me vlerë me afat maturimi prej 12 muajsh të emëtuara nga ana e Republikës së Maqedonisë dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, në bazë të autorizimit të Këshillit drejtues të Fondit;
6. është përgjegjës për likuiditetin e Fondit;
7. kujdeset për sigurinë e Fondit;
8. propozon akt për organizim dhe sistematizim të brendshëm të Fondit;
9. i emron dhe shkarkon punëtorët e Fondit me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, lidh dhe prish kontrata për punë me punëtorët;
10. jep udhëzime për punë dhe autorizime adekuade punëtorëve të Fondit;
11. përgatit dhe parashtron propozime dhe vendime deri tek Këshilli drejtues i Fondit për çështje të kompetencave të tij;
12. sjell raporte gjysmë vjetore dhe vjetore për punën e Fondit deri tek Këshilli drejtues i Fondit, ndërsa me kërkesë të Këshillit drejtues përgatitë raporte të jashtëzakonshme;
13. kujdeset për informimin e publikut për mënyrën dhe llojin e sigurimit të depozitave;

14. jep propozim – tekst të Njoftimit për depozitat të cilat janë të siguruar në Fond dhe për shumën e dëmshpërblimit nga ana e Fondit të cilën bankat dhe kursimoret janë të obliguar ta vendosin në vend të dukshëm në hapsirat e tyre afariste;

15. parashtron kërkesë deri tek Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe deri tek administratori për dorëzimin e raporteve në pajtim me nenin 25 të këtij statuti;

16. e informon Këshillin drejtues për arritjen e kushteve për ndërprerje të anëtarimit në Fond;

17. Vendos për çështje të tjera të cilat është kompetente sipas këtij Statuti.

Neni 39

Drejtori i Fondit, pas mbarimit të vitit afarist, i dorëzon Këshillit drejtues verzion të llogarisë vjetore dhe raport për punën e Fondit.

Me kërkesë të Këshillit drejtues, drejtori i Fondit përgatitë raport të veçantë për gjendjen e Fondit ose për ndonjë aspekt tjetër të punës së tij.

X. NDARJA E FITIMIT, BARTJA E RREZIKUT DHE MBULIMI I HUMBJES

Neni 40

Fondi i përcakton të ardhurat në pajtim me ligjin.

Nga të ardhurat e realizuara Fondi i mbulon shpenzimet e tij në pajtim me ligjin.

Neni 41

Pjesa e të ardhurave të punës së Fondit nga Llogaria vjetore të cilat do të mbesin pas mbulimit të të gjitha shpenzimeve, Fondi i paraqet si fitim.

Fitimi neto i realizuar nga puna e Fondit ndahen për:

- mbulimin e humbjeve nga puna e vitit të kaluar dhe

-rezervat e Fondit.

Vendimi për përcaktimin e fitimit neto të Fondit e sjell Këshilli drejtues i Fondit, e cila dërgohet në Qeverinë e Republikës së MAqedonisë për vërtetim.

XI. ORGANIZIMI I FONDIT

Neni 42

Fondi organizohet si një formë organizative (tërësi) në nivel të personit juridik, pa pjesë të veçanta organizative.

Neni 43

Punëtorët në Fond themelojnë marrëdhënie pune në pajtim me ligjin, marrveshjen kolektive dhe aktin të përgjithshëm të Fondit.

Neni 44

Organizimi dhe sistematizimi i brendshëm i deteyrave të punës në Fond më nga afër përcaktohet me aktine e përgjithshëm të cilin e përcakton të Fondit Këshilli drejtues, me propozim të drejtorit të Fondit.

XII. FSHEHTËSI AFARISTE

Neni 45

Këshilli drejtues me rregullore përcakton çka paraqet fshehtësia afariste.

Neni 46

Anëtarët e Këshillit drejtues të Fondit dhe person a të tjerë të cilët punojnë në Fond nuk guxojnë të publikojnë informacione të cilat paraqesin fshehtësi bankare ose tjetër të përcaktuar me ligj.

Detyrimi për ruajtjen e fshehtësisë afariste ka të bëjë me të gjithë të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit drejtues në Fondin për Sigurimin e Depozitave dhe vazhdon të vlej deri në tre vjet pas përfundimit të mardhënies së punës, gjegjësisht funksionit anëtar i Këshillit drejtues në Fond.

XIII. NDËRPRERJA E ANËTARËSIMIT NË FOND

Neni 47

Anëtarsimi në Fond ndërpritet:

- me kërkesë të anëtares, në rastet kur ajo kërkon ndërmprerjen e lejes së grumbullimit të depozitave, pas rregullimit(pastrimit) paraparak të gjithë obligimeve ndaj depozitave të personave fizik;

- kur banka, dega e bankës së huaj ose kursimorja nuk ka paguar në Fond premi në periudhë prej gjashtë muajsh njëri pas tjetrit;

- kur guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë do të ndërpresë lejen e themelimit të punës së bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores.

Këshilli drejtues i Fondit mund të vlerësoj dhe vendosë për ndërprerjen e anëtarsimit të bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores edhe në rast të mos pagimit të pagesës shtesë .

Për ndërprerje të sigurimit në Fond të bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores vendosë Këshilli drejtues i Fondit.

Neni 48

Fondi pa anilim e informon Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për ndërprerje të anëtarsimit në Fond të bankës së caktuar, degës së bankës së huaj ose kursimores.

Neni 49

Kur t'i përfundojë anëtarsimi në Fond bankës, degës së bankës së huaj ose kursimores pas cilës do arsyë të përcaktuara në nenin 48 të këtij Statuti, mjete e paguara në Fond deri në ditën e përfundimit të anëtarsimit, mbeten në Fond.

Neni 50

Fondi është i obliguar që ta publikoj mbarimin e anëtarësimit të bankës, filiales së bankës së huaj ose kursimores në mjetet e informimit publik dhe ta obligoj anëtarin që t'i tërheqë dhe t'i këthej njoftimet për depozitat të cilat janë të siguruara në Fond si dhe shuma e dëmshpërblimit nga ana e Fondit.

XIV. AKTE TË PËRGJITHSHËME TË FONDIT

Neni 51

Akte të përgjithshme të Fondit janë: rregulloret, regjistrat dhe akte të tjera të përgjithshme.

XV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 52

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të RM-së, ndërsa do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga nana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Shkup, mars 2015

Kryetar i Këshillit drejtues
Suzana Peneva